



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1615/ 10 prot.

Datë 23.07.2024

V E N D I M

Nr.943 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23 .07.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 861/2024, datë 11.07.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur” me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: “Mobilim i shkollës 9- vjeçare ‘Azem Hajdari’, Njësia Administrative, Babrru Paskuqan”, me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz

Ankimues: Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe me adresë: Njësia Administrative 11, Koder - Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr.492, Kamëz, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 11.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 861/2024, ku vendosi:
[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: “Mobilim i shkollës 9- vjeçare ‘Azem Hajdari’ Njësia Administrative, Babrru Paskuqan”, me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: “Mobilim i shkollës 9- vjeçare “Azem Hajdari’ Njësia Administrative, Babrru Paskuqan”, me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet dhe arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe t’i publikojë në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Klame” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr.6090 prot., datë 16.07.2024 protokolluar me tonën me nr.1615/7 prot., datë 19.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 861/2024 , datë 02.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: “Mobilim i shkollës 9- vjeçare ‘Azem Hajdari’, Njësia Administrative, Babrru Paskuqan”, me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr.6090 prot., datë 16.07.2024 protokolluar me tonën me nr.1615/7 prot., datë 19.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 861/2024, datë 02.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit "E hapur" me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: "Mobilim i shkollës 9- vjeçare 'Azem Hajdari', Njësia Administrative, Babrru Paskuqan", me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se shtojca për modifikimin e dokumentave e tenderit është publikuar në sistemin e prokurimit elektronik por ajo nuk është tërësisht në përputhje me vendimin nr.861/2024, datë 11.07.2024 të KPP-së.

II.2. Në nenin 24 pika e ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se: *"3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtesinë dhe eficienten, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit."*

Ndërsa në nenin 118 pika 2 të po këtij ligji parashikohet: *"2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*
- b) të pranohet ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulohet plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin*
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji,*
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik."*

II.2.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të K.P.P. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimmarrjes së organit kolegjal bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër vendimmarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimmarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësi të pakuptimtë.

II.2.2. KPP, në pikën III.6.8. të vendimit nr. 861/2024 datë 11.07.2024 është shprehur:

III.6.8. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti Kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt - prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që kërkon të blejë, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Duke marrë shkas nga pretendimi i ankimuesit “Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”,.....kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.” si dhe referuar “Rekomandimit Nr. 6732 Prot, datë 21.10.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik”, KPP gjykon, se kriteri më sipër për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit, në rastin kur operatori nuk është prodhues, është kërkesë e cila i referohet kapacitetit teknik të prodhuesit të produkteve, pra palëve të treta te cilat nuk jane konkurrent/kandidat ne proceduren konkrete te prokurimit. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e një kërkesë të tillë për paraqitjen e certifikatës ISO si më sipër të prodhuesit, nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues, pasi kërkesa të tilla janë për dokumente që u drejtohen palëve të treta që nuk janë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe që i vendosin operatorët ekonomikë të cilët janë joprodhues në një pozitë pabarazie në lidhje me përgatitjen e ofertave të tyre, pasi ju kërkohet dhe mund të vlerësohen (në fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave) mbi bazën e një dokumentacioni, i cili nuk lidhet me kapacitetin e tyre teknik e që do të shërbejë më pas si garanci për realizimin me sukses të kontratës, por me kapacitetin e palëve të treta, që nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën e prokurimit. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

.....”

Lidhur me këto konstatime të Komisionit, autoriteti kontraktor në shtojcën e hartuar në zbatim të vendimit të KPP nr. 861/2024 datë 11.07.2024 nuk e ka zbatuar këtë të fundit pasi për certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” nuk e ka hequr kërkesën e paraqitur të “shënim”: “Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, të paraqesë edhe Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente, për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuara, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.” duke rënë ndesh me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin më sipër.

Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesës së paraqitur në “shënim” në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr.861/2024 datë 11.07.2024.

III.3. KPP në pikën III.2.7. të vendimit nr. 861/2024 datë 11.07.2024 është shprehur:

“.....

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për paraqitjen e IQT (dëshmite e kualifikimit profesional teknik) për secilin prej punonjësve marangoz, KPP e gjen të egzagjeruar dhe jo në proporcion me volumin dhe kohëzgjatjen e kontratës, si dhe me mallrat që do të lëvrohen, pasi dëshmia për kualifikimin profesional teknik ka për qëllim sigurimin teknik të punonjësve gjatë ushtrimit të

profesionit të tyre në përputhje me ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, por nuk dëshmon nëse punonjësi ka formimin profesional apo jo si marangoz, profil i cili sipas autoritetit kontraktor, nevojitet për realizimin me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor me rëndësi është që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet e duhura teknike dhe profesionale, gjithnjë në funksion të realizimit me sukses të kontratës, të cilin në rastin konkret për marangozët, mund ta vërtetojë përmes dëshmive profesionale për profilin marangoz të lëshuara nga institucione publike apo private të akredituara, ku dëshmitë në kuptim të pikës 17 të nenit 4 të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” janë dokumente të llojeve të ndryshme të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit sipas një procedure e standardi të caktuar.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit më sipër, duke kërkuar dëshmi e certifikata që lidhen posaçërisht me vërtetimin e cilësive profesionale për punonjësit e profilin marangoz.

.....”

Nga verifikimi në shtojcën e publikuar në SPE rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka kryer modifikimet sipas konstatimeve më sipër të KPP. Autoritet kontraktor duhet të kërkojë vetëm certifikata që lidhen posaçërisht me vërtetimin e cilësive profesionale për punonjësit e profilin marangoz si dhe të specifikojë organin kompetent i cili duhet të lëshojë këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të jenë të qartë në përgatitjen e ofertave të tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-09025-06-11-2024, me objekt: “Mobilim i shkollës 9-vjeçare ‘Azem Hajdari’, Njësia Administrative, Babrru Paskuqan”, me fond limit 19,647,617.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e procedurës së mësipërme, sipas konstatimeve të KPP të shprehura në vendimin nr. 861/2024, datë 11.07.2024.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

